

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОБА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca filloj në ora 11 dhe u kryesua nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës Akademik. Nexhat Daci i cili e përshëndeti PSSP Michael Steiner dhe gjithë të pranishmit.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e grupit politik të AAK-së të paraqes emrin e anëtarit të Kryesisë .

Në emër të AAK-së foli Bujar Dugolli i cili propozoi: Bajram Kosumin –anëtar i Kryesis.

Për emrimin e Bajram Kosumit –anëtar i Kryesis deputetët votuan në këtë përbërje:

- 90 - të pranishëm
- 90 - për
- 0 - kundër
- 0 - apstenime

Pas votimit Bajram Kosumi - është bërë anëtar i 8- të i Kryesis.

Pastaj Kryetari kërkoi që të bëhet aprovimi formal i përbërjes së komisioneve dhe për këtë u votuan me këtë përbërje:

- 90 - të pranishëm
- 90 - për
- 0 - kundër
- 0 - apstenime

- Propozim nga Xheair Murati që në komisionin për Arsim Shkence dhe Teknologji të përfshihet edhe një anëtar me qenë se arsimit është qështje e rëndësishme dhe e ndieshme për minoritetet.

**Debat lidhur me çështjen e veriut të Mitrovicës dhe kufinj të Kosovës**

Në këtë debat u angazhuan një numer i madh i deputetëve dhe të gjithë ata shprehen paknaqësinë lidhur me situatën aktuale në veriun e Mitrovicës si dhe lidhur me kufinj të Kosovës.

Diskutuesit ishin të mendimit të hartohet një rezolut për mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës.

Pas këtij shqyrtimi foli edhe PSSP-ja z. Michael Steiner .

- Ai është i knaqrur me krijimin e institucioneve të Kosovës dhe të komisioneve të Kuvendit .

- Respekttoi debatin e të gjithë deputetëve që sipas tijë ishte shumë profesional edhe pse ai nuk pajtohet me të gjitha ato që janë theksuar nga ana e tyre.

- Ai përcolli diskutimet e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të mbajtur me datën 24.04.2002.

- Antarët e këtij Këshilli ishin të kënaqur me krijimin e institucioneve të Kosovës por ishin të paknaqur që në Kosovë nuk mbretrojnë siguri e plot, si dhe për mospërfshirjen e femrave në ministri..

- Ai ceku se nuk do të lejoj këtu gjendjen e vitit 1989 dhe nuk të këte ndarje të Mitrovicës.

- Porosia e tij për të gjithë të deputetët që të mos jenë në kundërshtim me Bashkësinë Ndërkombëtare.

- Sa i përket marrveshjes Serbi –Maqedoni këtë e ka pranuar Këshilli i Sigurimit prandaj unë nuk mundem të ndikoj aty asgjë.

Pas përfundimit të fjalimit të PSSP-së Kryetari Nexhat Daci lajmroi përfundimin e seancës dhe kërkoi nga dy komisionet, komisioni për çështje juridike, ligjdhënëse dhe të Komizës Kushtetuese dhe komisionit<sup>3</sup> për Bashkpunim Ndërkombëtar bazuar në debatin e ditës së sotme të dalin me një dokument përfundimtar lidhur me integritetin territorial të Kosovës.

**SHËRBIMI JURIDIK I KUVENDIT**

**PRISHTINË**  
**09.05.2002**